**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr. 5508 Rep.**
**Nr. 688 Kol.**

**AKTI I THEMELIMIT**
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**GENERAL G Shpk.**

Ne Tirane, sot me20.05.2003, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht:

Z. Florenc Gjikuria, shtetas shqiptar i datelindjes 12.01.1973, mbajtes i leternjoftimit me NF nr.035219, me banim ne Rruga Muhamet Gjollesha, apll 3/1, Blloku Vasil Shanto, Tirane

I cili me vullnetin e tij te plote e te lire, nenshkroi ne prezencen time, Aktin e Themelimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar GENERAL G Shpk.

- Ortaku i Vetem themelon nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin GENERAL G Shpk.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.
- Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj: Import –export, tregtim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore, ndermjetesim ne shitblerje, dhenie me qira e transaksione te tjera mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme (real estate), aktivitet ne fushen e turizmit dhe agjencive turistike, bar restorant, hoteleri. Tregtim me pakice te karburante dhe nenprodukteve te tyre, tregtim dhe prodhim i materiale te ndryshme te ndertimit, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- Shoqeria GENERAL G Shpk. e ka seline e saj ne adresen :Dhermi, Himare, Shqiperi.
  Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe 25 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.
  Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) Leke dhe eshte i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1.000 (njemije) Leke secila. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla, perkatesisht nga ortaku i vetem.
- Shoqeria do te administrohet nga ortaku i vetem. Administrator i vetem i shoqerise eshte Z. Florenc Gjikuria, shtetas shqiptar i datelindjes 12.01.1973, mbajtes i leternjoftimit me NF nr.035219, me banim ne Rruga Muhamet Gjollesha, apll 3/1, Blloku Vasil Shanto, Tirane. Administatori do te do te qendroje ne detyre si i tille per nje periudhe te pacaktuar.

Administratori do te pergjigjet personalisht perballe shoqerise ose te treteve per shkeljet e mundshme te ligjit dhe/ose te statutit. Administratorit i njihet e drejta e delegimit me prokure te funksioneve te tij ndaj personave te trete.

- Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne diten e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2003.

Ky Akt i Themelimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar behet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem dhe une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

**ORTAKU I VETEM**

FLORENC GJIKURIA

NOTER

GENERAL G SHPK

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**NR.** 5510 **REP.**
**NR.** 700 **KOL.**

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE

**STATUTI I SHOQERISE**
**ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**GENERAL G Shpk.**

Sot ne Tirane me 20/5/03 perpara meje noterit te Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht personi I meposhtem I cili kerkoi redaktimin e statutit te meposhtem:

**EMERTIMI - FORMA -BAZA LIGJORE**

**Neni 1**
Ortaku I vetem eshte:
Z. Florenc Gjikuria, shtetas shqiptar i datelindjes 12.01.1973, mbajtes i leternjoftimit me NF nr.035219, me banim ne Rruga Muhamet Gjollesha, apll 3/1, Blloku Vasil Shanto, Tirane

**Neni 2**
Shoqeria emertohet GENERAL G Shpk. dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

**Neni 3**
Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara nga ky Statut dhe Akti i Themelimit.

**OBJEKTI - SELIA**

**Neni 4**
Shoqeria ka per objekt: Import –export, tregtim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore, ndermjetesim ne shitblerje, dhenie me qira e transaksione te tjera mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme (real estate), aktivitet ne fushen e turizmit dhe agjencive turistike, bar restorant, hoteleri. Tregtim me pakice te karburante dhe nenprodukteve te tyre, tregtim dhe prodhim i materiale te ndryshme te ndertimit, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 5**
Shoqeria GENERAL G Shpk e ka seline ne adresen: Dhermi, Himare, Shqiperi

**Neni 6**

**Neni 6**
Adresa e ligjshme e ortakeve per çdo raport me shoqerine eshte selia e shoqerise.

**Neni 7**
Shoqeria mund te hape dege e zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe/ose jashte saj.

**KOHEZGJATJA - KAPITALI**

**Neni 8**
Shoqeria do te kete nje kohezgjatje prej 25 vjetesh.

**Neni 9**

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) Leke dhe eshte i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1.000 (njemije) Leke secila. Kapitali i shoqerise nenshkruhet dhe derdhet teresisht ne te holla, perkatesisht nga ortaku i vetem. Kapitali i shoqerise mund te rritet/zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem.

**Neni 10**
Kuotat jane te transferueshme ne perputhje me ligjin.

**Neni 11**
Ortaku i vetem pergjigjet per detyrimet karshi te treteve deri ne vleren e kapitalit te saj.

**ORGANET E SHOQERISE**

**Neni 12**
Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem i emeruar nga Ortaku i Vetem
Administrator i vetem i shoqerise eshte Z. Florenc Gjikuria, shtetas shqiptar i datelindjes 12.01.1973, mbajtes i leternjoftimit me NF nr.035219, me banim ne Rruga Muhamet Gjollesha, apll 3/1, Blloku Vasil Shanto, Tirane.
Administatori do te do te qendroje ne detyre si i tille per nje periudhe te pacaktuar.
Administratori do te pergjigjet personalisht perballe shoqerise ose te treteve per shkeljet e mundshme te ligjit dhe/ose te statutit. Administratori kryen administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, te gjitha veprimet qe ai i konsideron te nevojshme per realizimin e qellimit te shoqerise, perjashtuar vetem ato veprime, te cilat ligji dhe Statuti ia rezervon, ne menyre taksative Ortakut te Vetem. Administratori ka kompetenca te dipsonoje dhe te tjetersoje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, te bleje kuota dhe/ose aksione ne shoqeri te tjera, te kryeje çdo lloj veprimi prane Bankave, Instituteve te Kredise, organeve publike dhe private, te kryeje regjistrime ipotekore, te heqe dore nga ipotekat si ligjore. Administratorit i njihet e drejta e delegimit me prokure te funksioneve te tyre ndaj personave te trete te zgjedhur prej tyre

**Neni 13**
Administratori miraton llogarite dhe bilancin e shoqerise, brenda 3 (tre) muajve nga perfundimi i vitit financiar dhe ne baze te tij merr vendimet perkatese per shperndarjen e fitimeve dhe fondet rezerve.

**Neni 14**
Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment me vendim te Ortakut te Vetem. Shkarkimi duhet te jete i motivuar.

**Neni 15**
Eksperti kontabel, ne rastet kur ligji e kerkon detyrimisht emerimin e tij, ai emerohet dhe vepron ne perputhje me ligjin.

**VITI FINANCIAR I SHOQERISE - LIKUJDIMI**

**Neni 16**
Çdo vit fianànciar fillon ne 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te çdo viti.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne diten regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbyllet ne 31 dhjetor 2003.

**Neni 17**
Ne çdo moment e per çdo arsye qe arrihet ne shperndarjen e Shoqerise, normat per kryerien e likujdimit dhe emerimin e Likuidatorit do te vendosen nga Ortaku i Vetem sipas dispozitave te Ligjit shqiptar.

**NORMA REFERUESE - KOMPETENCA**

**Neni 18**
Per sa nuk parashikohet prej ketij Statuti behet referim ne ligjet shqiptare ne fuqi ne fushen e shoqerive tregtare.

**Neni 19**
Autoriteti gjyqesor ne Republiken e Shqiperise ka kompetenca ekskluzive per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis Ortakut te Vetem dhe organeve te shoqerise, midis shoqerise dhe te treteve, etj.

**Neni 20**
Ky statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar GENERAL G Sh.p.k. perpilohet ne kater kopje ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhen rregullisht nga Ortakut te Vetem.

**ORTAKU I VETEM**
FLORENC GJIKURIA

**NOTERI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE